

# QENDRA E STUDIMEVE DHE PUBLIKIMEVE PËR ARBËRESHËT



Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave për krijimin e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët nr. 601, datë 04.09.2019 si dhe Ligjit nr. 7961, datë 12. 7. 1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, QSPA do të shpallë në faqen zyrtare të internetit konkursin për pozicionin:

## PASQYRA E PUNËS

<b>POZICIONI I PUNËS</b>	<b>Specialist Kërkues Shkencor</b>
<b>DEPARTAMENTI</b>	<b>Drejtoria e Studimeve dhe Publikimeve</b>
<b>ADRESA E QSPA</b>	<b>Rruga “Ibrahim Rugova”, Sky Tower, nr. 7/4, Tiranë</b>
<b>RAPORTON TEK</b>	<b>Drejtori i Drejtorisë së Studimeve dhe Publikimeve</b>

## PËRSHKRIMI I PUNËS (DREJTORIA E STUDIMEVE DHE PUBLIKIMEVE)

Objekti i punës së Drejtorisë së Studimeve dhe Publikimeve është:

- Konceptimi, organizimi dhe realizimi i kërkimeve dhe studimeve të thelluara në lëmitë e ndryshme të spektrit arbëresh;
- Zhvillimi i projekteve që hyjnë në fushën e veprimit të QSPA-së, duke mobilizuar e bashkërenduar burime njerëzore dhe materiale brenda dhe jashtë QSPA-së;
- Nxitja e këtyre kërkimeve nëpërmjet organizimit të seminareve, konferencave, takimeve, apo eventeve;
- Valorizimi i rezultatit të këtyre aktiviteteve nëpërmjet publikimeve dhe akteve të tjera njohëse dhe promovuese.

## DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

Kryen studime themelore në fushën e tij/saj të specialitetit, e cila është një nga disiplinat, apo një kombinim i disiplinave të shkencave sociale të aplikuara mbi komunitetet arbëreshe si :

- Histori/ Histori e Mesjetës;

Shkruan dhe publikon, në suportet e QSPA-së si faqja web dhe suportet e tjera të komunikimit elektronik, botimet e QSPA-së, aktivitetet, shtypin periodik të QSPA-së, etj.

Merr pjesë në organizimin e konferencave dhe seminareve shkencorë, të cilat i mbështet me ide, përmbajtje dhe organizim.

- Të jetë i aftë të realizojë, përveç kërkimit shkencor në disiplinën përkatëse, një apo disa nga aktivitetet që hyjnë në objektin e punës së Drejtorisë së Studimeve dhe Publikimeve, të cilat do t'i caktohen nga eprorët sipas nevojave të kalendarit të veprimtarive ;

## EDUKIMI DHE TRAINIMET

## Edukimi dhe eksperiencia që kërkojmë:

- Të zotërojë titullin “Doktor” në fushën e Historisë (Parapëlqehet të jetë specialist i mesjetës dhe në veçanti i studimeve mbi arbëreshët);
- Të ketë të paktën 5 vite eksperiencë pune në fushën për të cilën punësohet ;
- Të ketë aktivitet kërkimor-shkencor dhe botime në disiplinën përkatëse;
- Të përmbushë kriteret e punësimit që përcaktohen nga aktet ligjore dhe nën-ligjore në fuqi;
- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të jetë i certifikuar në gjuhë të huaj , minimumi niveli C1 (Italisht ose Anglisht).

## AFTËSITË

- Aftësi vendimmarrëse dhe interpretuese
- Aftësi pune në grup
- Komunikim shumë i mirë
- Aftësi të mira në përballimin e punës nën presion

## KUSHTET E PUNËS

### MJEDISI I PUNËS

Mjedisi i punës, karakterizohet nga ambjentet e përshtatshme dhe të mirëorganizuar për punën kërkimore e studimore.

### ORARI I PUNËS

Nga e hëna në të enjte, orari është nga ora 08:00 deri në orën 16.30.  
Ditën e premte, orari është nga ora 08:00 deri në orën 14:00.

## Kandidatët që aplikojnë, duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim ku shpreh interesin për të aplikuar për pozicionin e punës.**
2. **Jetëshkrim (CV) në formatin Euro Pass.**
3. **Fotokopje të diplomave universitare dhe të titullit “Doktor”**
4. **Referencë nga të paktën një profesor**
5. **Fotokopje të librezës së punës ose vërtetime nga punëdhënësit, të cilat vërtetojnë eksperiencën në punë.**
6. **Kopje të artikujve, teksteve, revista, projekte shkencore etj.**
7. **Certifikata që vërtetojnë zotërimin e gjuhës së huaj.**

**Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave të bëhet brenda datës 24/07/2020 ora 14:00, në Zyrën e Protokollit të QSPA-së në rrugën “Ibrahim Rugova”, pallatit “Sky Tower”, kati i shtatë, ap. 4, si dhe në adresën e e-mail: [info@qspa.gov.al](mailto:info@qspa.gov.al)**

## Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësitë të cilat do të zhvillohet intervista:

- Njohuri mbi ligjin nr. 80/2015 datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.
- Njohuri të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për fushën e mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë.

## **Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

- Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv.

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

## **Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e konkurimit**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) do të shpallë fituesin faqen zyrtare të institucionit.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga QSPA-ja, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail)